



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura III

Nr. 7

Prishtinë, më 11 prill 2008, ora 11:00

**Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës,
salla C-203**

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Hajdin Abazi, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Besa Gaxherri, Kosara Nikolić, Shkumbin Demaliaj, Xhevdet Neziraj.

Anëtarët që munguan: Behxhet Pacolli, Müfera Şinik.

Të pranishëm ishin edhe : monitorues nga NDI, OSCE, KDI.

Nga Sekretaria e Kuvendit: Natasa Prica-Tisma, administratore e Komisionit, Arta Hajra, zyrtare ligjore, Vilson Ukaj, zyrtar ligjor, Dashurie Canolli, nëpunëse administrative.

Të pranishëm në pjesën e parë të mbledhjes ishin edhe: Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi dhe Sekretari i Kuvendit z. Ismet Krasniqi.

Kryesues: Gani Koci, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës i propozuar:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

3. Shqyrtimi i Projektligjit për taksën e vendosjes me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. L– 021/1 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie sociale, me amendamente;
5. Shqyrtimi i propozim Rregullores për punën e komisioneve të Kuvendit, i propozuar nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, me përfundimin nr. 03/0302/Do-144 të Kryesisë së Kuvendit;
6. Të ndryshme
 6. 1. Informim lidhur me shpenzimet financiare të Kuvendit sipas rregullës 6.8 të Rregullores së Punës të Kuvendit.
I ftuar: Sekretari i Kuvendit.

Pasi që në mbledhje ishin të pranishëm edhe Kryetari i Kuvendit, i cili me vet dëshirë i është bashkangjitur takimit të komisionit për shqyrtimin e pikës 6 të rendit të ditës dhe Sekretari i Kuvendit, i ftuar nga komisioni, Kryetari i Komisionit hapi mbledhjen duke propozuar rirenditje të pikave të rendit të ditës. Propozimi ishte që pika e gjashtë e rendit të ditës të jetë pika e dytë e tij.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

Kryetari hapi për shqyrtim pikën e dytë të rendit të ditës

2. Të ndryshme

2. 1. Informim lidhur me shpenzimet financiare të Kuvendit sipas rregullës 6.8 të Rregullores së Punës të Kuvendit.

Kryetari bëri të ditur për Komisionin se për këtë pikë të rendit të ditës nuk është kërkuar raportim, pasi që nuk ka ndonjë dokument për të cilin do duhej të raportohej, por vetëm informim lidhur me shpenzimet financiare që kohët e fundit janë miratuar në Kryesinë e Kuvendit, duke vepruar sipas pikës 6.8 të Rregullores së Punës.

Kryetari ftoi Kryetarin e Kuvendit dhe Sekretarin e Kuvendit që të paraqesin mendimin e tyre para komisionit.

Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi shprehu gatishmërinë e tij për të mbështetur punën e komisionit, duke theksuar se është ihtar i respektimit të të gjitha rregullave të cilat janë në fuqi e që rregullojnë punën si të komisioneve ashtu edhe të organeve tjera të kuvendit. Rregullorja e punës së Kuvendit, edhe pse ka mjaft mangësi dhe nevojë për tu harmonizuar me Kushtetutën e miratuar të Republikës së Kosovës, ajo megjithatë është në fuqi dhe duhet zbatuar.

Në rregulloren e tanishme rregulla 6 përcakton kompetencat e Kryesisë së Kuvendit, ku sipas Kryetarit të Kuvendit, Kryesia nuk e ka tejkaluar asnjë kompetencë të saj me rastin e marrjes së vendimit për disa kategori shpenzimesh, duke vepruar sipas rregullës 6.8. Mirëpo, ai shprehu interesimin e tij që disa lëshime që janë bërë në vendimet e legjislaturave të kaluara, do duhet të rregullohen tani nga Kryesia me propozim të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ndër to ai përmendi si defekt formën e kompensimit të deputetëve për punën në komisione, ku një deputet i cili është anëtar i dy komisioneve kompensohet njëjtë për punën e tij, sikurse deputeti që është anëtar i vetëm një komisioni. Këtu dallon vetëm lartësia e ndëshkimit në bazë të mungesës së deputetit në punën e komisionit. Gjithashtu, sipas kryeparlamentarit do duhej të ndahen përgjegjësitë mes deputetëve dhe mos ketë koncentrim pozitash dhe privilegjesh vetëm te një

numër i vogël deputetësh, por pozitat që përmbajnë privilegje do duhej të shpërndahen te një numër më i madh deputetësh.

Kryetari i Kuvendit inkurajoi anëtarët e komisionit që të bëjnë propozimet e tyre lidhur me kompensimin dhe çështjet tjera financiare që kanë të bëjnë me funksionimin e brendshëm të Kuvendit, e po ashtu edhe për disa mangësi të Rregullores së Kuvendit të jepen propozime dhe rekomandime për ndryshime nga ana e Komisionit në bashkëpunim me sekretarin, të cilat do ti përcillen më pas Kryesisë së Kuvendit e cila do të jetë e interesuar për ti përkrahur.

Kryetari i Komisionit falënderoi Kryetarin e Kuvendit për praninë e tij në mbledhje të komisionit dhe përkrahjen e dhënë. Mirëpo, ai theksoi edhe nevojën që shpërblimi i deputetëve dhe anëtarëve të Kryesisë të bëhet në bazë të vëllimit të punëve, meqë ka raste kur angazhimet e anëtarëve të komisioneve tejkalojnë për nga vëllimi punët e anëtarëve të Kryesisë. Sipas z. Koci komisioni është i interesuar të dijë se për vendimet e fundit të Kryesisë a është shikuar baza ligjore dhe mundësitë financiare. Gjithashtu, ai theksoi edhe nevojën e angazhimit të ekspertëve përkatës për të ndihmuar punën e komisioneve, sidomos kur duhet të bëhen ekspertiza më profesionale buxhetore, ose edhe të tjera.

Për të ardhmen z. Koci shprehu vullnetin e tij dhe të komisionit për një komunikim më të mirë në mes Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Kryesisë lidhur me çështjet financiare dhe që çdo vendim i tillë të merret me dijeninë dhe konsultim të komisionit.

Haki Shatri theksoi se rregullorja e tanishme nuk paraqet pengesë për Komisionin për Buxhet dhe Financa që për ndonjë çështje financiare të propozojë ndonjë lëvizje buxhetore brenda kufijve buxhetor vjetor të miratuar, për të cilin propozim do të vendos Kryesia e Kuvendit.

Gjithashtu sipas z. Shatri, raporti tremujor nga ana e Sekretariatit të Kuvendit nuk mundet të kërkohet brenda ditësh sepse duhet kohë për përgatitje të një raporti të tillë financiar.

Besa Gaxherri tregoi arsyen e saj dhe të anëtarëve të komisionit që kanë pasur kur kanë kërkuar që të thirret sekretari për informim para komisionit, se kjo ka pasur të bëjë me qëllim të vërtetimit të informatave gojore që deputetët kanë marrë lidhur me disa vendime të Kryesisë për disa kategori shpenzimesh. Ajo kërkoi që në të ardhmen për çështjet financiare Kryesia duhet të konsultojë paraprakisht komisionin e pastaj të marrë vendime, sepse përndryshe mund të kalohet në parregullsi. Z. Gaxherri gjithashtu u interesua lidhur me kompensimet e deputetëve për punën e tyre, dhe kërkoi të rregullohet kompensimi i udhëtimit, sepse sipas saj një pjesë e madhe deputetësh diskriminohen në bazë të kritereve të tanishme, për faktin se për deputetë që udhëtojnë pagesa është e njëjtë kurse jo të gjithë deputetët janë të një largësie të njëjtë nga Prishtina, rrjedhimisht dikush paguan më shumë e dikush më pak.

Xhevdet Neziraj ishte i pajtimit me parafolësit e tij për sa i përket gjetjes së formës më të përshtatshme për mënjanimin e parregullsive si në rregulloren e tanishme ashtu edhe nga vendimet e kaluara për çështje të kompensimeve të deputetëve. Po ashtu ai u interesua për mënjanimin e parregullsive që janë paraqitur te disa parti lidhur me ndarjen e buxhetit për partitë e përfaqësuara në Kuvend, pasi që ekziston rreziku që disa parti të ngrenë padi ndaj Kuvendit duke kërkuar kompensim të drejtë.

Shkumbin Demaliaj ishte i mendimit se informatat e dhëna nga të ftuarit në mbledhje do të ishte mirë ti ishin ofruar në formë të shkruar Komisionit, në mënyrë që të informohen më mirë me vendimet e Kryesisë dhe gjithashtu të bëhet e ditur se nga cilat linja buxhetore është vendosur të realizohen shpenzimet e miratuara.

Pas diskutimeve dhe komenteve të anëtarëve të komisionit, **Sekretari i Kuvendit** njoftoi anëtarët se të gjitha aktivitetet financiare në Kuvendin e Kosovës bëhen në mbështetje të dispozitave ligjore.

Sa i përket vendimeve të fundit të Kryesisë lidhur me disa kategori shpenzimesh, ai theksoi se Kryesia ka vendosur në mënyrë analoge sipas vendimit që Qeveria ka marrë për shpenzime të njëjta për anëtarët e Qeverisë. Me qëllim që të ketë një harmonizim sa më të mirë për sa i përket kompensimeve të deputeteve sipas pozitave të tyre (kompensimi për shpenzimet e telefonisë), Kryesia ka përmirësuar sërish vendimin e saj për dy pozita të deputetëve.

Sa i përket raportit financiar tremujor të Kuvendit, Sekretari i njoftoi deputetët se ai disponon me të dhënat e para për shpenzimet buxhetore tremujore, por pasi që ende është në përgatitje raporti i tërësishëm tremujor, ai ishte i mendimit që komisioni këtë çështje ta vë në rend dite në ndonjë mbledhje tjetër të ardhshme, pasi që është herët të jepen informata të sakta për këtë tremujor, meqë muaji mars sapo ka përfunduar. Kurse, për angazhimin e ekspertëve për komisionet parlamentare, Sekretari theksoi se angazhimi afatshkurtër i ekspertëve nuk paraqet problem, pasi që kanë mundësi të angazhohen në periudha të shkurtra javore, ose 10 ditore, mbi bazën e kontratës për punën e kryer. Përderisa, për angazhim afatgjatë të ekspertëve apo krijim të një zyre ekspertësh për komisione parlamentare pranë Kuvendit, nuk ka rregullativë ligjore, mirëpo një propozim për formën dhe mënyrën e angazhimit të tillë dhe kompensimit të ekspertëve, do të duhej të vinte nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Sekretari në vazhdim paraqiti para komisionit brengën që vazhdimisht e përcjellë Kuvendin gjatë parashikimeve të shpenzimeve buxhetore vjetore për projektet kapitale, gjegjësisht lidhur me projektin e vazhdimeve të punimeve në Qendrën Protokollare “Gërmia”, pasi që nevoja për shuma të mëdha të mjeteve financiare për këtë projekt dhe problemet në vazhdimësi me punë kryesit, kanë bërë që punimi për qendër ende të mos përfundojë.

Duke u inkuadruar në këtë problematikë, **Kryetari i Kuvendit** bëri të ditur iniciativën që si Kryesi do të kërkojnë që në projektin e Qendrës Protokollare të përfshihen edhe Presidenca dhe Qeveria duke ndarë mjete financiare për përfundimin e të njëjtit, pasi që Qendra Protokollare do të jetë në shërbim edhe të këtyre institucioneve.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe komenteve nga të pranishmit, me propozim të Kryetarit të Komisionit, Komisioni vendosi në mënyrë unanime për krijimin e një grupi punues brenda Komisionit për Buxhet dhe Financa për të shqyrtuar dhe paraqitur një raport me rekomandime para Komisionit, për çështjet në vijim:

- Propozimi për formën dhe mënyrën e kompensimit financiar për punën e deputetëve, anëtarëve të komisioneve, grupeve parlamentare dhe anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit
- Propozimi i lartësisë së kompensimit për shpenzimet e udhëtimit për deputetë, në bazë të kilometrave të largësisë së vendbanimit
- Propozimi për formën dhe mënyrën e angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve afatshkurtër dhe afatgjatë për komisionet parlamentare.
- Propozimi i formës, mënyrës së ndarjes dhe shumës së mjeteve buxhetore për aktivitet edhe funksionimin e komisioneve parlamentare.

Anëtarët e grupit punues janë:

1. Haki Shatri, kryesues
2. Safete Hadergjonaj, anëtare
3. Besa Gaxherri, anëtare
4. Xhevdet Neziraj, anëtar.

Grupi punues obligohet që në afat sa më të shkurtër kohor të fillojë punën dhe në bashkëpunim me Sekretarin e Kuvendit dhe Divizionin e Kuvendit për Buxhet dhe Pagesa, të paraqesë pranë Komisionit raportin e tij me rekomandime.

Kryetari vazhdoi me hapjen për shqyrtim të pikës së tretë të rendit të ditës

3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua me vërejtjen e z. Armend Zemaj për një përmirësim gjuhësor në diskutimin e tij.

Kryetari vazhdoi me hapjen për shqyrtim të pikës së katërt të rendit të ditës

4. Shqyrtimi i Projektligjit për taksën e vendosjes me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente

Kryetari paraqiti qëndrimin e tij lidhur me projektligjin në shqyrtim dhe raportin me amendamente të komisionit funksional duke thënë se projektligji me amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore, por me këtë projektligj rregullohet çështja e pagesës së taksës për vendosjen në objektet hoteliere dhe turistike.

Gjithashtu ai propozoi për komisionin që në raportin e njëjtit për këtë projektligj të përfshihet si sugjerim që amendamenti 1 i raportit të komisionit funksional, që ka të bëjë me amendamentimin e preambulës së projektligjit, të sqarohet në seancë plenare nga kryetari i atij komisionit dhe ti sugjerohet Kuvendit që preambulat e ligjeve të cilat i miraton Kuvendi, të harmonizohen me rregullat e Kushtetutës të Republikës së Kosovës.

Këto propozime u përkrahën nga anëtarët tjerë të komisionit.

Pas diskutimeve dhe komenteve nga ana e anëtarëve të komisionit, kryetari vuri në votim projektligjin me amendamentet e komisionit funksional dhe Komisioni me shumicë votash nxori këtë

Rekomandim

- I.** Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për taksën e vendosjes dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II.** Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe të njëjtat në tërësi i përkrahë.
- III.** Sugjerime:
 - Komisioni për Buxhet dhe Financa i sugjeron Kuvendit, që gjatë kohës së shqyrtimit të amendamenteve, të kërkojë sqarim nga ana e kryetarit të komisionit funksional për Amendamentin 1 të komisionit funksional, me të cilin propozohet ndryshimi i preambulës së projektligjit.
 - Komisioni për Buxhet dhe Financa i sugjeron Kuvendit që preambulat e ligjeve të cilat i miraton Kuvendi, të harmonizohen me rregullat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në vazhdim kryetari hapi shqyrtim pikën e katërt të rendit të ditës

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. L- 021/1 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie sociale, me amendamente

Armend Zemaj, gjithashtu anëtar i komisionit funksional për këtë projektligj, njoftoi anëtarët e komisionit për qëndrimet e komisionit funksional lidhur me projektligjin. Sipas tij, Komisioni funksional pas takimeve konsultative që i ka pasur me zyrtarë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka marrë informacionet e nevojshme dhe ka hartuar raportin me amendamente për të bërë disa plotësime të nevojshme në projektligj, kurse projektligji është përkrahur si i nevojshëm për të përmirësuar dhe plotësuar ligjin ekzistues për skemën sociale.

Sa i përket implikimeve buxhetore, z. Zemaj u shpreh se ky projektligj sikur që ceket edhe në deklaratën e tij financiare nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, nuk përmban dhe nuk do të krijojë implikime buxhetore, përkundrazi do të ketë kursim, pasi që parashihet që një numër më i madh i personave do të lirohet nga asistenca sociale dhe këto mjete do të rishpërndahen për personat tjerë që do të fitojnë asistencë sociale me ligj.

Pas këtyre sqarimeve, kryetari vuri në votim projektligjin me amendamentet e komisionit funksional me shumicë votash nxori këtë

Rekomandim

- I.** Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin e Ligjit nr. L-02/1 për skemën e ndihmës sociale dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II.** Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe të njëjtat në tërësi i përkrahë.
- III.** Bazuar në të lartshënuarat, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

Në vazhdim kryetari hapi shqyrtim pikën e pestë të rendit të ditës

5. Shqyrtimi i propozim Rregullores për punën e komisioneve të Kuvendit, i propozuar nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me përfundimin nr. 03/0302/Do-144 të Kryesisë së Kuvendit

Kryetari paraqiti qëndrimin e tij për këtë projekt rregulloren, të propozuar nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, i hartuar nga Instituti Nacional Demokratik (NDI) dhe i përcjellë nga Kryesia në Komisionin për Buxhet dhe Financa për të paraqitur rekomandimet lidhur me implikimet buxhetore të të njëjtit.

Sipas Kryetarit, si në aspektin formal juridik, material juridik dhe metodologjisë së hartimit, ky projekt nuk mund të përkrahët, pasi që hartimi i rregullores së punës së komisioneve parlamentare është i një rëndësie shumë të madhe për funksionimin e punës së komisioneve, kështu që Kuvendi duhet të autorizojë një komision kompetent për hartim të rregullores së tillë dhe gjatë shqyrtimit të kyçen të gjitha komisionet tjera. Në formën siç është proceduar projekti i rregullores për punën e komisioneve parlamentare, i njëjti është i papranueshëm dhe i pazbatueshëm .

Kryetari propozoi që në emër të Komisionit ti përcillen rekomandime Kryesisë së Kuvendit lidhur me projekt rregulloren e propozuar. Ai ftoi anëtarët për të votuar dhe me shumicë votash Komisioni nxori këto:

REKOMANDIME

1. Me qëllim të vendosjes së rregullave unike për organizimin dhe funksionimin e punës së përhershme të komisioneve parlamentare, e duke pasur parasysh rëndësinë që ka Rregullorja për punë të komisioneve, është e domosdoshme që Kuvendi të autorizojë komisionin kompetent për hartimin e një projekti të një rregulloreje të tillë, duke përfshirë në shqyrtim të gjitha komisionet tjera parlamentare në bashkëpunim me administratën e Kuvendit.
2. Nga aspekti formal juridik, material juridik dhe metodologjia e hartimit të Projektit të rregullores së ofruar nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, e njëjti është i papranueshëm dhe i pazbatueshëm, për këtë është e nevojshme rishqyrtimi, plotësimi dhe ndryshimi i tij nga ana e komisionit kompetent të autorizuar nga Kuvendi, me qëllim të largimit të mungesave dhe lëshimeve të tij.
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa, si i thirrur nga Kryesia e Kuvendit për të paraqitur rekomandimet e tij lidhur me implikimet buxhetore të projekt rregullores së ofruar, nuk ka qenë në gjendje për të parashikuar dhe përcaktuar implikimet financiare e të njëjtit, për arsye se rregullat të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet buxhetore dhe financiare, janë të përgjithësuara dhe të pa qarta.
4. Për zbatimin e rekomandimeve të lartshënuara, duhet të vendoset një bashkëpunim i plotë midis të gjitha subjekteve të inkuadruara në hartimin dhe shqyrtimin e Projekt rregullores mbi punën e komisioneve parlamentare, që duhet t'i dërgohet për miratim Kuvendit të Kosovës, dhe hartuesit e saj t'i miratojnë plotësisht vërejtjet dhe sugjerimet, sepse ato janë të orientuara në mënjanimin e të metave me qëllim të begatimit dhe të aplikimit të drejtë në praktikë.

Kryetari konstatoi se mbledhja përfundoi në orën 12.30

Procesverbalin e përgatiti
Shërbimi i komisioneve

Kryetari i Komisionit

Gani Koci